

SKËNDERBEU FIGURË E SHQUAR E HISTORISË SONË KOMBËTARE

Farida RAMADANI

Studiuese, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Besa shqiptare ishte një virtut tjetër që u manifestua në kohën e Skënderbeut, për të cilën të huajt folën e shkruan me admirim. Skënderbeu me sjelljet dhe veprimtarinë e tij, forcoi dhe kaliti një virtut tjetër karakteristik të popullit tonë, nderin në familje dhe në shoqëri dhe ishte i papajtueshëm me imoralitetin. Ai ishte njerëzor dhe kurrë nuk i la ushtarët e tij të plaçkitnin viset armike, të terrorizonin pleqtë e qiliminjtë, të çnderonin gratë. Shqiptarët preferonin më mirë vdekjen sesa të binin në dorë të armikut. Kronisti bizantin Kritobulli, që shoqëronte Sulltan Fatihun në rrethimin e II të Krujës (1466), ka shkruar: *”Disa ilirianë (shqiptarë), duke parë se ndiqeshin nga hoplitët dhe pasi nuk gjetën asnjë vend për t’u strehuar, u hodhën poshtë që nga shkëmbenjtë në hapësirën e përrenjve”*. Historia e Skënderbeut lidhet me historinë politike, ekonomike, ushtarake, kulturore të popullit shqiptar e të vendit të tij në shek. XV dhe në shumë pikëpamje do të ndeshet me historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare në shkallë evropiane, sepse i tillë qe rrezatimi i gjerë i domethënies botërore të kësaj lufte.

Fjalë kyçe: besë, virtut, manifestim, të huaj, kalit, figurë.

ABSTRACT

The Albanian faith was another virtue, which was manifested in the time of Skanderbeg, about which foreigners spoke and wrote with admiration. Skanderbeg with his behavior and activity, strengthened and tempered another characteristic virtue of our people, honor in the family and society and was incompatible with immorality. He was human and never let his soldiers plunder enemy areas, terrorize elders and carpets, dishonor women. Albanians preferred death to falling into the hands of the enemy. The Byzantine chronicler Kritobulli, who accompanied Sultan Fatih in the second siege of Kruja (1466), wrote: *from the rocks to the space of the streams*”. The history of Skanderbeg is related to the political, economic, military, cultural history of the Albanian people and his country in the century. XV and in many respects will encounter the history of international relations on a European scale, because such was the wide radiance of the world significance of this war.

Key words: trust, virtue, manifestation, foreign, temper, character.

HYRJE

Për të përkujtuar me rastin e 550 vjetorit të vdekjes figurën e ndritur të heroit kombëtar, Skënderbeut, ky vit është shpallur vit jubilar i Skënderbeut, më 17 janar 1468. Ai me veprën e tij të lavdishme ishte për një çerek shekulli mburoja e pathyeshme e Atdheut kundër ushtrive më të forta që kishte bota, ushtrive të sulltanëve të Turqisë. Një vend të rëndësishëm në historinë e popullit tonë për forcimin dhe kalitjen e traditave kombëtare zënë luftrat dhe rezistenca për më shumë se një shekull (1385-1506) kundër vërshimit të pushtimit turk. Por në këtë periudhë, një vend të artë zënë luftrat nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, kur populli ynë formoi dhe kaliti virtutet morale me karakter thellësisht kombëtar. Fitore të mëdha historike arriti populli ynë nën udhëheqjen e Skënderbeut në:

1. realizimin e bashkimit të forcave kombëtare.
2. forcimin e solidaritetit të shqiptarëve të krahinave të ndryshme.
3. manifestimin e virtutit të trimërisë, guximit e shpirtit të sakrificës.
4. manifestimin e virtutit të besës

5. manifestimin e virtytit të nderit në familje dhe në shoqëri

6. manifestimin e virtytit të dashurisë për atdheun, lirinë e pavarësinë.

7. konsolidimin e traditave patriotike (etja e pashuar për liri, përpjekjet për fitoren e lirisë e mbrojtjen e pavarësisë), luftarake (disiplina, guximi, gjakftohtësia, forca fizike, zemërgjerësia) dhe ato revolucionare.

Skënderbeu me vullnet e guxim të patundur, që shkonte deri në heroizëm, frymëzonte masën e luftëtarëve, duke marrë pjesë personalisht në momentet kritike të betejës. Ai ishte një strateg i madh. Ai vishej thjeshtë, kurse ushtatët donte t'i kishte të veshur bukur, hante e flinte si ata, kujdesej vazhdimisht për jetën e ushtarëve, fshatarëve sllavë e grekë. Këto cilësi të rralla populli ynë e tregoi se i kishte të pashtershme.

Tiparet dalluese të Skënderbeut

Të pakta janë figurat historike (zvicerani Vilhelm Tel e francezja Zhanë D'Ark), që kanë gjetur jehonë kaq të gjerë në literaturën botërore gjatë shekujve, siç është figura e shqiptarit Skënderbe. Ai ishte Davidi që u ndesh me kaq beteja legjendare vigane me "Goliatin" osman dhe doli kurdoherë fitimtar. Për të tregoheshin mrekulli në të katër anët e botës qysh më të gjallë dhe vazhduan edhe pas vdekjes, kur reliket e tij konsideroheshin si sende që i garantonin bartësit paprekshmëri e pavdekshmëri. Ai bashkonte në personalitetin e vet elemente të islamit e të krishtërimit, të botës orientale, gjuhën dhe kulturën e së cilës ai e njihte dhe njëkohësisht luftonte, siç e quante papa, si një "ledh mbrojtës" i krishtërimit e qytetërimit evropian. Ai mishëronte në një mënyrë shembullore unitetin shpirtëror të popullit në luftë për identitet dhe unitet, dukuri aq e jashtë zakonshme e aq e rrallë në atë kohë në botë. Ai ishte për shkrimtarët figurë ndërdushëse midis Lindjes dhe Perëndimit, midis detyrës dhe dashurisë ndaj atdheut dhe lakmisë për pushtet, midis dashurisë për familjen e vendlindjen e dashurisë për princeshat fisnike, të cilat i refuzoi për t'i mbetur besnik detyrës dhe vokacionit si luftëtar "athlete christi" për çështjen e lirisë. Ai ishte strategu ushtarak që me forca relativisht të vogla e të kufizuara, me anë të një strategjie mbrojtëse, dinte të përballonte një kundërshtar superior.

Figura e Skënderbeut e parë nga të huajt

Historia kurorën e lavdisë ia dha Skënderbeut e popullit të tij me cilësitë më të larta fisnike: dashurinë për liri e pavarësi, për tokën e vendin e vet. Në fazën e kalimit nga mesjeta në historinë e re evropiane, Shqipëria dhe figura e Skënderbeut hynë për të zënë një vend qendror në historinë botërore, gjë që pasqyrohet më së miri në rritjen e hovshme të botimeve kushtuar kësaj epoke në literaturën botërore. Historianë e filozofë, ushtarakë e shkrimtarë (shqiptar dhe të huaj) të të gjithë shekujve kanë shkruar më shumë se 1000 vepra e punime të ndryshme (shkencore, historike, biografike, bibliografike, monografike, artikuj shkencor, recensionë kritike, vepra letrare, si: drama, tragjedi, opera, romane, poema etj), krijime të arteve figurative, të folklorit, të strategjisë, të teknikës ushtarake etj, mbi luftrat e figurën e Skënderbeut dhe kanë theksuar veçanërisht trimërinë e tij e të shqiptarëve.

Papa Kalisti III, në vitin 1458, duke parë forcën luftarake të Skënderbeut, deklaroi: *"Në të vërtetë shohim se si pothuajse i vetëm i është vënë përballë furisë së turqve aq mizorë, si një mur shumë i qëndrueshëm, që e pengon afrimin e tyre"*. Një kronist venedikas, Antonio Sabeliko, pati shkruar në vitin 1487: *"Populli i këndon trimëritë e tij të çuditëshme me vjersha solemne dhe më kanë treguar burra të denjë për t'u besuar, se në mes të zjarrit të luftës, në çastin kur çdo gja dridhej përpara armëve të barbarit, një numër i madh vajzash mblidhej çdo tetë ditë në udhëkryq të atyre vendeve, ku Skënderbeu kishte sunduar dhe këndonin lavdinë e princit të vdekur, ashtu siç e kishin zakon të moçmit ndër gostitë e heronjve të mëdhenj"*. Sulltan Mehmeti II sa dëgjoi për vdekjen e Skënderbeut u shpreh: *"Një sultan të tillë nuk e sheh më bota! Tani Europa dhe Azia janë ndër duar të mia"*. Spanjollli Lope de Vega 1562 –1635) e anglezi Marlou (Marlow) i kushtuan homazhin e vet

Skënderbeut në krijimtarinë artistike. Më pas vijnë italianët Skarameli (B.Scaramelli) (1580), Sarochi (M. Sarochi), hungarezi Bogati (M. Bogati-Fazekas, 1575) etj. Prifti çek Jakob Pontano (G. Pontanus) më 1609 botoi një antologji me fjalimet e Skënderbeut të nxjerra nga Barleci. Figura e heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu u bë burim frymëzimi për hartimin e një vargu të gjatë veprash të shkruara në shekuj, ndër të tjerë edhe nga pena të *literaturës franceze* të shekujve 16-18. Të para në tërësi këto vepra mund të ndahen në dy grupe kryesore. Ato me katakter të mirëfilltë me vërtetësi historike e ato me karakter artistik të gjinive të ndryshme, si: romane, novela, pjesë teatrale, opera etj. të hartuara për qëllime të caktuara. Më e hershja midis tyre është vepra e Zhan Lavarden (J.Lavardin), aristokrat francez nga Vandoma, e botuar në vitin 1576 në Paris me titull: “Historia e Gjergj Kastriotit të quajtur Skënderbe - Mbret i Shqipërisë”.

Në fjalën drejtuar fisnikëve ai ju tërheq vëmendjen se “kjo është jeta e Gjergj Kastriotit të quajtur Skënderbe, Mbret i Shqipërisë (emërtim i dalë për herë të parë nga Lavarden), emri i pavdekshëm i të cilit është i denjë pa asnjë dyshim të futet në tempullin e kujtimit” dhe u drejtohej francezëve: ”*ndiqni shembullin e Skënderbeut, hiqni dorë nga lufta vëllavrasëse dhe luftoni kundër të huajve që ju shkelin tokën amtare*”. Ai ka meritën se ka mbledhur një varg konsideratash e vlerësimesh të personaliteteve të kohës mbi heroin shqiptar. Aty gjejmë një listë me 33 autorë që kanë shkruar për Skënderbeun, ku vendin e parë e zë Marin Barleti me dy veprat e tij “Histori e Skënderbeut” dhe “Rrethimi i Shkodrës”. Vlerësimin e Volarentanit për Skënderbeun si pasues të Pirros, si personazh i denjë për emrin e Aleksandrit të madh. Edhe konsideratat e humanistit bashkëkohës Enea Pikolomini (Ae. S. Piccolomini), i cili ka thënë: ”Nuk qenë shekujt që e zbehën këtë figurë të madhe, përkundrazi Gjergj Kastrioti i mposhti shekujt”. Tek tre sonetet e përfshira në vepër, njëra e poetit Pierre de Ronssard (1524-1585), i cili e krahason Skënderbeun me Akilin, të tjerat të letrarit Florent Krestien, i cili thërret francezët të marrin shembullin e Skënderbeut. Si edhe Amadis Zhemini përkthyes i Iliadës në frëngjisht në odën e tij lartëson idealin e luftës vetmohuese për mbrojtjen e tokës amtare.

Në vitin 1709, në Paris në veprën e tij Zhan Nikolla Dyponse “Historia e Skënderbeut - Mbret i Shqipërisë”, e cila përmban 6 libra dhe 591 faqe (variant i shkurtër i “Historia e Skënderbeut” të Barletit), shkruan se: ”Duhet të njohësh pak historinë që të mos dish se në shek. XV ka pasur një princ ose mbret të Shqipërisë dhe shpresoj që njerëzit me mend dhe të përsëritshëm do të bekojnë Zotin që i dha krishtërimin një mbrotës të tillë dhe do t’i luten t’u dërgojë shpesh të tillë”. Ai e paraqet figurën e Skënderbeut me cilësi fizike e morale të një burri të madh shteti të denjë për popullin e vet dhe për qytetërimin evropian. Në pinakotekën e kështjellës së pushimit të Mbretit të Francës Fransua I, në Boregard midis burrave më të shquar e më të lavdishëm të botës së të gjitha kohërave deri atëherë, ndodhet edhe porteti i Skënderbeut, duke e përjetësuar atë.

Historiani italian Giorgio Biemmi në vitin 1742 tregon kështu: ”Unë nuk di nëpër mend vallë, në gjithë historinë e lashtë dhe të re, një hero që të përmbledhë në vetvete kaq veti të rralla e cilësi shpirtërore dhe të jetë kaq i ngjeshun mirë nga trupi si ai i yni. Në kohën e betejave të ashpra kundër turqve, ai nuk pushonte asnjë çast, por ishte gjithnjë në lëvizje e veprimtari të vazhdueshme. Ishte i pari që hynte në betejë dhe i fundit që tërhiqej, futej në përleshje dhe u binte armiqve pa u dalluar nga ushtari i thjeshtë. Sipas shembullit të tij dhe sipas jetës së tij ishin edukuar edhe ushtarët, tek të cilët nuk binte në sy asnjë shenjë shburrnimi, por të gjithë i shtroheshin disiplinës si në çështje ushtarake, ashtu edhe për sa i përket sjelljes në jetën shoqërore. Me cilësitë e tij të rralla dhe me miqtë e popullit liridashës, Skënderbeu, sado që ishte prijës i një populli të vogël dhe pa mjete, mundi t’i sjellë kësulën rrotull një goxha Turqie”.

Ushtaraku anglez U.Templ (W.Temple) dhe strategu i shek. XVII, komandanti anglez Xh. Volfi (J. Volfe), formuloi si aksiomë mendimin e tij se: Skënderbeu kishte qenë dhe mbetej përgjithmonë një

shembull i shkëlqyer i një strategu që me forca relativisht të vogla e të kufizuara, me anë të një strategjie mbrojtëse, dinte të përballonte një kundërshtar superior. Në vitin 1756 Volfe shprehet kështu: "në qoftë se do të mund të shtinim në dorë një përshkrim të mjaftueshëm të trimërive të Skënderbeut, ky do të ishte një material i paçmueshëm, sepse ai shkëlqeu mbi të gjithë kapedanët e vjetër e të rinj në udhëheqjen e një ushtrie të vogël mbrojtëse"

Mund ta kuptojmë qartë rolin, që luajti Skënderbeu për atë kohë, përmes fjalëve të filozofit francez Fransua Volter (1694 -1778), i cili ka shfaqur mendimin, se: "Historia botërore mund të kishte marrë një rrugë tjetër, në qoftë se, në vend të perandorëve të shburruar bizantinë, të kishin qëndruar Skënderbeu e shqiptarët", si dhe "Sikur perandorët bizantinë të qenë Skënderbej, Perandoria e Lindjes do të kishte shpëtuar". Për iluminizmin evropian të shek. XVIII, Skënderbeu qëndronte mbi dhe jashtë feve fanatike, siç ishin islami dhe krishtërimi, si udhëheqës i masave popullore, burrë shteti ideal, mbret "i urtë" e filozof. Autori dalmat S. Xanoviçi (S. Zannovitch) e paraqet heroin në mënyrë anakroniste, si kombinacion të filozofit dhe mbretit iluminist në veprën "Kastrioti i madh i Shqipërisë". "Me Skënderbeun filloi koha heroike e popullit trim shqiptar"- ka thënë historiani gjerman Ludvig Paster (1854-1928).

Ndërsa historiani tjetër gjerman Follmerayer (1790-1861) ka thënë: "Për turp të madh të fqinjëve më të fuqishëm, por më pak të vendosur, shqiptarët e mbrojtën pavarësinë dhe nderin e armëve të atdheut, përmbi një gjysmë shekuli me trimëri dhe këmbëngulje". Si dhe jep këtë mendim në vitin 1860: "Siç dihet nga e gjithë bota, Gjergj Kastrioti është një nga më të përsosurit e më të mëdhenjtë mjeshtër lufte të të gjitha kohërave". Andrea Papadopulos Vreto në vitin 1820 ka shkruar një libër historik. Poeti i madh Henry Wadsworth Longfellow (1807 –1882) shkroi një vjershë tregimtare "Skënderbeu - figurë e shquar e historisë sonë kombëtare. Në historinë e teatrit evropian, veçanërisht të Evropës Perëndimore, në Spanjë, në Francë, në Austri e në Gjermani, nuk munguan një varg veprash me temën e Skënderbeut, si dhe komedianët ambulante profesionistë anglezë dhe gjermanë, për qëllimet e tyre, duke e shpënë deri tej në Evropën Lindore

Figura e Skënderbeut e parë nga shqiptarët

Marin Barleci, shkodrani siç e quan ai veten me krenari. po aq artist sa dhe historian, me dy veprat e tij "Histori e Skënderbeut" dhe "Rrethimi i Shkodrës" është krenari për ne, pasi hyri në letërsinë botërore, ashtu siç hyri heroi i tij. Vepra e dytë dhe më e rëndësishme që ka shkruar historiani Marin Barleci, është "Historia e Skënderbeut" (Titulli i plotë: Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, princit të epirotëve), që e bëri të njohur autorin gjithandej në Europë. Vepra është shkruar në latinisht dhe botuar në Romë, rreth viteve 1508-1510. "Historia e Skënderbeut" e Barlecit pati një jehonë të madhe në Europë. Këtë e dëshmojnë përkthimet e saj në disa gjuhë, si në: gjermanisht, italisht, portogalisht polonisht, frëngjisht, spanjisht, anglisht, por edhe në shqip nga prof. Stefan Prifti, të shoqëruar me një hyrje të gjatë me karakter studimor. Prof. Stefan Prifti, përkthyesi i botimit të parë të kësaj vepre (1964), në botimin e dytë (1967) i bëri disa ndreqje botimit të parë, duke e ripunuar, si dhe duke pajisur tekstin me shënime, veçanërisht me ngjarjet historike, me personat, me toponimet etj. Si dhe duke bërë disa shtesa e plotësime, lidhur me origjinën, influencën dhe idetë e Marin Barlecit.

Më pas Dhimitër Frangu, njeri i rrethit të heroit të Krujës (ai i përkiste një familje të madhe drishtiane), më 1539 shkroi një tjetër libër historik "Historia e Skënderbeut" të mbështetur te Barleci. Ai bëri përpjekje plot erudicion për të ruajtur mendimin mbi origjinën shqiptare të heroit. Marin Beçikemi nga Shkodra me një fjalim panegjirik, Gjon Muzaka, bashkëlufëtari i Skënderbeut me "Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve" më 1510 dhe Marin Barleci me "Rrethimi i Shkodrës" kanë lënë vepra me vlera autentike për historiografinë shqiptare për epokën e Skënderbeut. Veprat e Pjetër Bogdanit dhe të Andrea Engjëllit përbëjnë një dëshmi të nivelit intelektual të

shqiptarëve bashkëkohës dhe të patriotizmit për të përjetësuar heroin, siç bënte folklori me këngët epike dhe legjendat.

Poeti i madh Naim Frashëri shkroi veprën “Histori e Skënderbeut” etj.

Shkrimtari Kolë Jakova shkroi poemën “Garda Krutane.

Edhe Shkrimtari Ismail Kadare “Varrimi i Skënderbeut”.

Shkrimtari Sabri Godo shkroi romanin “Skënderbeu”.

Temën e Skënderbeut, të heronjve të krishterë luftëtarë kundër “të pabesëve” nuk munguan ta lëvronin edhe shkrimtarë edhe poetë që vinin nga radhët e klerit katolik, si p.sh jezuitët që në shkollat e tyre e bënë heroin shqiptar hero të një vargu dramash e tragjedish.

Përkrenarja e Skënderbeut

Një herë Skënderbeu ishte rrethuar keq nga turqit brenda në kështjellë. Rrethimi vazhdoi për një kohë të gjatë. Shqiptarët qëndruan si burrat, por kur panë se rezervat e ushqimit po mbaroheshin, iu lutën Skënderbeut, që të hapnin portat e kështjellës, të dilnin jashtë, të luftonin e të vriteshin me shpatë në dorë, siç u kishte hije. Edhe atë punë do ta bëjmë: - foli Skënderbeu, por kur të jetë nevoja. Kundër këtyre egërsirave duhet përdorur shpata, aq sa edhe mendja. Le të mundohemi mos ia dalim me këtë të dytën. Nata ishte e zezë pus, ashtu si shpirti i turqve, të cilët kishin ngritur çadrat e tyre në kodrat përreth kështjellës dhe prisnin që të dorëzoheshin shqiptarët. Befas dëgjohet që brenda kështjellës një tingull i fortë brini, që pasohet me të rrahurat e trumbetave. Portat e kështjellës hapen dhe që andej vrapojnë nga të katër anët ushtarë me pishtarë flake në duar. Ushtria s’kishte të mbaruar. Ajo sulej drejt armikut me shpejtësi të rrufeshme. Turqit s’patën kohë të mendonin se ç’po ndodhte. Duke parë rrezikun që i priste ua mbathën këmbëve. Ç’kishte ndodhur? Ku e gjeti Skënderbeu gjithë atë ushtri?

Puna qëndronte kështu: Skënderbeu kishte dhënë urdhër që të mblidheshin nga popullsia e strehuar në kështjellë të gjitha dhitë. Natën ua lyen dhive brirët me peshkve, dhe pasi u ranë trumpetave për t’u tërhequr vëmendjen turqve, u vunë zjarrin brirëve të dhive e hapën portat e kështjellës. Dhitë të tmerruara, ia dhanë vrapit. Këta qenë “ushtarët me pishtarë në dorë” që i dhanë fitoren Skënderbeut. Kështu ai përdori me zotësi dinakërinë ushtarake, e mashtrroi armikun dhe fitoi. Thuhet se për të përjetuar këtë fitore, ushtarët menduan që në përkrenaren e Skënderbeut të gdhendnin një kokë dhije me dy brirë. Ja, pra pse përkrenarja e Skënderbeut është e tillë, sipas kësaj legjende që ndeshet ende sot në Krujë.

Në Macukull të Matit shprehen kështu për Skënderbeun: S’ka pasur tjetër si Skënderbeu. Ai ka qenë me fletë nën sjetull. Mustaqet i kishte katër pëllëmbë më njëren anë e katër në tjetrën. Kur luftonte Skënderbeu i bëheshin sytë gjak edhe nxirrte duhëm prej goje. Kur ishte i sëmurë Skënderbeu thirri njerëzit e tij e u tha: Shtini duart në brez të njëri-tjetrit, që të bani njëni-tjetrin e mos t’ju çajë bota.

PËRFUNDIME

1. Tema e Skënderbeut përbën një nga ato tema madhore, kurdoherë aktuale që duke shkuar përtej interesit thjesht shkencor e duke qëndruar në nivelin më të lartë të interesit, që i kushtoi letërsia botërore, për nga pesha dhe rëndësia zë gjithmonë një vend të veçantë në historinë e luftërave çlirimtare të popujve.

2. Figura e Skënderbeut e pasqyruar në prodhimet historiografike e letrare është prodhim i historisë, i shijeve dhe interesave, rrymave letrare artistike dhe koncepteve filozofike që mbizotëronin në secilën epokë, duke iu përshtatur problemeve dhe interesave të saj.
3. Lavdia e traditave patriotike - luftarake të kohës së Skënderbeut mbeti vazhdimisht e gjallë në ndërgjegjjen e popullit tonë, në rezistencën dhe kryengritjet e njëpasnjëshme, që u bënë kundër pushtuesve turq. Me flamurin e Skënderbeut, rilindasit ngritën popullin në luftë për pavarësi kundër pushtimit shekullor turk, me flamurin e Skënderbeut, Shqipëria njihet në botë edhe sot e kësaj dite.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu lindi në vitin 1412.
2. Thuhet se shkoi peng në pallatin e Sulltan Muratit II në vitin 1421, bashkë me tre vëllezër të tjerë.
3. Për merita të shquara Sulltani e emëroi Sanxhakbej në vitin 1431.
4. Gjergj Kastrioti, që u emërua nga Sulltani “Skënderbe”-e tregoi trimërinë e forcën e vet në ndeshjen me Tartarin, të cilin e rrëzoi përdhe dhe i këputi kokën, në vitin 1437.
5. Skënderbeu ngadhënjën përsëri kundra dy persjanëve të fuqishëm në vitin 1438 dhe fitoi kështu një emër të shkëlqyer në perandorinë osmane.
6. Kthimi i Skënderbeut në Atdhe në vitin 1443. Skënderbeu organizon Kuvendin e Lezhës, ku për të parën herë bëhet bashkimi i princave shqiptarë, për t’u hedhë në luftë të bashkuar kundër pushtuesit osman. Kuvendi i Lezhës mbahet në Lezhë më 2 mars 1444.
7. Lufta e Mokrenës kundër Firuz Pashës 1445.
8. Lufta e Otonetës kundra Mustaf Pashës, shtator 1446.
9. Lufta kundër Venedikut, 1448.
10. Lufta e Oranikut kundër Mustaf Pashës, tetor 1448.
11. Rrethimi i parë i Krujës 14 maj-26 tetor 1450.
12. Sulltan Murati II me 100.000 ushtarë thyhet në Krujë më 1451.
13. Lufta e Modrizës, korrik 1452.
14. Lufta e Pollogut, prill 1453.
15. Lufta e Mokrenës, gusht 1459.
16. Lufta e Ohrit kundër Sheremet Begut, 1464.
17. Luftat me Ballaban Pashën, prill-shtator , prill-shtator 1465.
18. Rrethimi i dytë i Krujës e udhëtimi i Skënderbeut në Romë, 1466.
19. Rrethimi i tretë i Krujës 1467, ku vetë Sulltan Mehmeti II i fuqishëm me 130.000 ushtarë, thyhet me turp prej Skënderbeut.
20. Vdekja e Skënderbeut më 17 janar 1468, në qytetin e Lezhës.
21. I pari që hartoi një bibliografi të Skënderbeut dhe e botoi në kushte të vështira ishte bibliografi i apasionuar G.Petroviç (G. Pétrovitch), ku regjistroi njëqind e tetëdhjetë botime vetëm në gjuhët e Evropës Perëndimore. Më pas kemi punime të F.Palit (F. Pall), F. S. Nolit, B. Ashkomit (B.Ashcom), V. Popovit, Y. Jakës, Karl Gëllner (C. Göllner) në dy vëllime kushtuar temës së luftës kundër osmanëve në shek. XV. Dh. S. Shuteriqit etj. si dhe dy vëllimet bibliografike të Bibliotekës Kombëtare” Albanica”(1965, 1987). Tanimë ky numër ka kaluar mijëshin. Numri i botimeve është një tregues i qartë për peshën e luftës popullore e heroit e po aq elokumente në këtë drejtim është larmia tematike si dhe shtrirja aq e gjerë gjeografike e vendeve nga të cilat vijjnë ato.